REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 021682 Datë: 16.12.2021
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit /
Ministarstvo Obrazovanja Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit	Kancelaria Ministra	Cabinet of Minister
Inspektorati i Arsimit	Inspektorat Obrazovanje	Inspection of Education

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A	**13.12.2021**
REFERENCË:	**Nr 10.prot.: 1263 datë : 13.12.2021**
PËR/ZA/TO:	**Akademia " jCorders" – Prishtinë**
Cc	**Milot Hasanxhekaj,** ekspert për kualifikime
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**z. Defrim Gashi** drejtor i përgjithshëm në Inspektoratin të Arsimit
NGA/OD/FROM:	**Shyhrete Reçica,** inspektore e arsimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Vendim Nr. 1263 datë: 13.12.2021 për ndërprerjen e veprimtarisë aftësuese dhe edukative arsimore.**

I/e nderuar

Ju lutem te gjeni Vendimin e bashkëngjitur!

Me respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit	Kancelaria Ministra	Cabinet of Minister
Inspektorati i Arsimit	Inspektorat Obrazovanje	Inspection of Education

Ref. 10
Nr. 1263
Datë: 13.12.2021

Bazuar në nenin 1, nenit 2, Nenit 8, paragrafi 5; nenit 13 pika 1 (1.11) dhe 2.2 ; Neni 14, paragrafi 1 dhe 2.2; dhe 2.4 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës (Ligji Nr.06/L-046-Gazeta zyrtare Nr.13/10 gusht 2018), Neni 46 paragrafi (1,2,5) i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Ligji nr.04/L-032-Gazeta Zyrtare nr.17/2011), Ligjit për kualifikimet kombëtare (Ligji Nr.03/L-060), Udhëzimit Administrativ nr.35/2014 për *kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë*, Kornizës Kombëtare të Kulalifikimeve; UA Nr. 05/2019 *(MASHT)* ; Procesverbalit Ref 10 Nr. prot. 891 dt. 30.09.2021, dhe Procesverbalit Ref. 10 Nr. prot.1195 datë: 22.11.2021 inspektorja e arsimit, harton :

VENDIM

1. **Akademia "jCorders" të ndërprejë veprimtarinë aftësuese – edukative arsimore, të cilën e ushtron pa licencë nga Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit (*MASHTI)* dhe pa riakreditimin e programeve në bazë të kritereve nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve – *(AKK) në periudhën e vitit 2020/2021.***
   Afati menjëherë !

2. **Akademia "jCorders" në Prishtinë, nuk i ka zbatuar rekomandimet sipas procesverbalit me nr. prot. 891 dt. 30.09.2021 lëshuar nga inspektorati i arsimit – MASHTI, pasi që ka konstatuar gjendjen faktike, gjithashtu edhe pas riinpsketimit dhe** Procesverbalit Ref. 10 Nr. prot.1195 datë:22.11.2021, **nuk i ka zbatuar rekomandimet sipas legjislacionit në fuqi .**

Vendimi hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit

Arsyetim

Për të konstatuar gjendjen faktike lidhur funksionimin e veprimtarisë së akademisë "jCorders", në Prishtinë, janë realizuar inspektime sipas procesverbaleve : Ref.10 **Nr. prot. 891** dt. **30.09.2021.** si dhe procesverbalit të riinspektimit Ref.10.Nr.prot.1195 datë: 22.11.2021, dhe **akademia " jCorders", nuk i ka zbatuar rekomandimet e inspektoratit të arsimit duke ushtruar fushëveprimtarinë pa programe të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve** *(AKK)* **si dhe pa license nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë** *(MASHTI).*

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit ekzistues, janë konstatuar parregullësi, të cilat janë paraqitur në procesverbale : Ref.10 Nr. prot. 891 dt. 30.09.2021, si dhe Nr.10. Prot.1195 datë: 22.11.2021, ku poashtu janë dhënë rekomandime për zbatim të menjëhershëm.

1. Pasi që inspektorati i arsimit nuk ka marrë informatë lidhur me përmbushjen e rekomandimeve, përveq E_mailit nga academia "jCorders' më datë: 08.12.2021, e cila ka konfirmuar pranimin e procesverbalit të riinspektimit, duke aluduar se ju është pranuar kërkesa për riakreditim ne Autoriteitin Kombëtar të Kualifikimeve *(AKK) e cila ka qenë e njohur për ne*, **pasi që kërkesa e "jCorders" për riakreditim ju është pranuar nga Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve** *(AKK)* **më datë:** 14.10.2021 ref 10 Nr. 980.

Ndërsa të njëjtit nuk janë përgjigjur për zbatimin e rekomandimeve nga inspektorati i arsimit *(MASHTI)*

Pasi që u konstatua se nuk janë realizuar asnjë nga rekomandimet e dhëna pas inspektimeve dhe rekomandimeve në procesverbalet e dala nga inspektorati i arsimit, për ndërprerjen e punës edukativo arsimore pa license nga MASHTI (*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*) dhe pa akreditim nga AKA (*Autoriteti Kombëtar për Kualifikime*), andaj, u mor vendimi nr 1263 13.12.2021.

Duke u bazuar nga të dhënat e cekura më lartë, prandaj edhe u vendos si në dispozitiv.

Këshillë juridike

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur, në afat prej tridhjetë (30) ditësh mund të parashtrojë ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në shkallën e dytë të IA-së.

Vendimi i dërgohet:

1. **Kabinetit të Ministres së Arsimit** *(MASHTI);*
2. **Akademia " jCorders"- Prishtinë ;**
3. **Departamentit të Arsimit Profesional në** *(MASHTI);*
4. **Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve** *(AKK);*
5. **Arkivit të Inspektoratit të Arsimit** *(MASHTI);*

Shyhrete Reçica
Inspektore e Arsimit----------